

# MEMO

<i>Datë:</i> 17. 09. 2020	
<b>Për: Armend Zemaj,</b> Ministër i Shëndetësisë	<b>Lul Raka,</b> Kryesues i Bordit Këshillëdhënës për Covid-19
<b>RAPORT NGA MBLEDHJA E SHITATË E BORDIT KËSHILLËDHËNËS PËR COVID-19</b>	

## PËRMBLEDHJE E QËNDRIMEVE TË BORDIT KËSHILLDHËNËS ANTI-COVID 19

- Të miratohet plani i veprimit për parandalimin e infeksioneve spitalore
- Të sigurohet oksigjen i mjaftueshëm për klinikat që trajtojnë pacientë me Covid-19 dhe të shikohen alternativat e tjera të teknologjisë moderne në furnizimin me oksigjen
- Të hapen bibliotekat me kapacitete të kufizuara ( $\frac{1}{4}$  deri  $\frac{1}{3}$ ) dhe me zbatim të plotë të masave parandaluese dhe inspektim nga autoritetet përgjegjëse
- Mos të përdoren kabinat (tunelët) dezinfektues në shkolla
- Rekomandimet e përdorimit të maskave të jenë në përputhje me këshillat e Bordit nga mbledhja paraprake

## 1. PLANI I VEPRIMIT PËR PARANDALIMIN E INFEKSIONEVE SPITALORE

Infeksionet që merren gjatë ofrimit të kujdesit shëndetësor përbëjnë kërcënim për sigurinë e pacientit dhe cilësinë e mbrojtjes shëndetësore. Këto infeksione përcillen me sëmundshmëri, vdekshmëri dhe kosto të lartë. Parandalimi dhe kontrolli i infeksioneve në institucionet shëndetësore është njëri nga standardet e cilësisë dhe ka rol qenësor për mirëqenien dhe sigurinë e të sëmurëve, punëtorëve shëndetësorë dhe vizitorëve. Me qëllim të adresimit të këtyre çështjeve është përgatitur Plani i veprimit për parandalimin e infeksioneve spitalore sipas kërkesës së MSH dhe është dorëzuar në Tetor 2018.

Qëllimi i këtij Plani të veprimit është mbrojtja e pacientëve dhe punëtorëve shëndetësorë nga infeksionet spitalore gjatë ofrimit të kujdesit shëndetësor. Aktivitetet dhe rekomandimet e planifikuara të Planit të veprimit janë në përputhje me rekomandimet e Këshillit të Evropës për Sigurinë e Pacientit (2009/C151/01), Programet e Sigurisë së Pacientit të OBSH-së, planin global të veprimit të OBSH-së për rezistencën antimikrobike (RAM) dhe me Strategjinë Sektoriale të Shëndetësisë (SSSh 2017-2021).

Objektivat specifike janë:

1. Përmirësimi i qeverisjes në parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve.
2. Vetëdijësimi i publikut dhe rritja e kompetencave profesionale të punëtorëve shëndetësorë dhe personelit ndihmës për parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve.
3. Fuqizimi i sistemeve të mbikqyrjes së infeksioneve spitalore
4. Avansimi i kapaciteteve laboratorike të mikrobiologjisë klinike
5. Promovimi i doktrinës 'Siguria e pacientit' dhe strategjisë multimodale

Në Maj të vitit 2020, me kërkesë të Ministrisë të Shëndetësisë është përditësuar ky plan me përfshirjen edhe të një kapitulli për emergjencat shëndetësore, me theks në COVID-19.

Plani i veprimit për parandalimin e infeksioneve spitalore 2019-2021 ka kaluar të gjitha fazat e përcaktuara në UA nr. 07/2018 për planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit si dhe Manualin për planifikimin, hartimin dhe monitorimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të tyre të veprimit.

Është bërë shqyrtimi dhe komentimi i draftit nga institucionet tjera, konsultimi publik, marrja e pëlqimit nga Zyra për Planifikim Strategjik e Zyrës së Kryeministrit si dhe kostimi nga Gripi Punues për kostim në MSh.

Përkundër riprocedimit në ish-Kabinetin e dy Ministrave, dokumenti nuk është aprovuar dhe Grupi punues nuk ka pranuar informata kthyesë apo komente lidhur me shkaqet e mosaprovimit.

Një pjesë e buxhetit të paraparë tashmë është realizuar ose është në procedim e sipër.

Janë realizuar aktivitetet që kanë të bëjnë me hapjen dhe furnizimin e laboratorit të mikrobiologjisë klinike në QKUK, si donacion nga Agjencia Italiane për Bashkëpunim Ndërkombëtar në vlerë prej 240.000 euro. Në procedurë të prokurimit janë 100.000 Euro për pajisje laboratorike në IKSHP, kurse 210.000 Euro janë paraparë për vaksinimin e punëtorëve shëndetësorë për hepatit B dhe grip. Buxheti i paraparë për COVID-19 ka qenë 400.000 Euro, nga të cilat një pjesë e konsiderueshme është investuar tashmë në këtë lëmi.

**Rekomandimi i Bordit: Të miratohet plani i veprimit për parandalimin e infeksioneve spitalore.**

## 2. MUNDËSITË DHE SFIDAT E FURNIZIMIT ME OKSIGJEN NË SHSKUK

Sipas të dhënave të OBSH-së, përafërsisht 14% e njerëzve me COVID-19 zhvillojnë sëmundje me pasqyrë të rëndë klinike që kërkon hospitalizim dhe oksigjenoterapi, kurse 5% kërkojnë pranim në njësitë e kujdesit intensiv. OBSH ka dhënë rekomandimet e detajuara dhe specifikimet teknike të nevojshme në procesin (shih vegzën e mëposhtme:

[https://www.who.int/medical\\_devices/priority/Tech\\_Specs\\_O2\\_Therapy\\_monitoring\\_final\\_draft.pdf?ua=1](https://www.who.int/medical_devices/priority/Tech_Specs_O2_Therapy_monitoring_final_draft.pdf?ua=1)

Furnizimi me oksigjen ka qenë ndër sfidat kryesore në menaxhimin klinik të pacientëve me COVID-19 në spitalet e Kosovës. Në kohën e rënies së lakores epidemiologjike të rasteve të reja dhe hospitalizimeve, kjo periudhë duhet të shfrytëzohet maksimalisht për përgatitjet e furnizimit të mjaftueshëm me oksigjen dhe për renovimet përkatëse nëpër klinikat ku trajtohen pacientët e infektuar me COVID.

Një alternativë tjetër e furnizimit me oksigjen është edhe prodhimi autonom dhe i vazhdueshëm i oksigjenit përbrenda institucioneve shëndetësore, përmes pajisjeve të teknologjisë moderne.

<https://www.novairmedical.com/en/production-equipment/oxygen-production>

**Rekomandimi i Bordit: Të sigurohet oksigjen i mjaftueshëm për klinikat që trajtojnë pacientë me Covid dhe të shikohen alternativat tjera të teknologjisë moderne në furnizimin me oksigjen.**

### 3. TË TJERA

---

**Bibliotekat:** Rekomandohet hapja e Bibliotekave me kapacitet të kufizuara  $\frac{1}{4}$  deri  $\frac{1}{3}$  dhe me zbatim të plotë të masave parandaluese dhe inspektim nga autoritetet përgjrgjëse.

**Kabinat (tunelët) dezinfektuese në shkolla:** mos të përdoren, sepse nuk kanë kurrfarë efekti mbrojtës nga infektimi me SARS-CoV-2.

**Maskat:** rekomandimet e përdorimit të maskave të jenë në përputhje me këshillat e Bordit nga mbledhja paraprake, të cilat bazohen në dëshmitë aktuale shkencore.

*Pjesëmarrës në takim: Lul Raka, Sanije Xhemajli, Besim Kodra, Xhavit Rexhaj, Xhavit Gashi, Pashk Buzhala, Ferid Agani dhe Izet Sadiku.*